

Rezyme përfundimtare
Për raportin nga
zbatimi i ligjit për
Parandalimin dhe
mbrojtjen nga
diskriminimi



2019 - 2022

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit
“Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi: Avancimi i politikave dhe praktikave
për mbrojtje nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë”,
i cili financohet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni.
Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe përfituesit të grantit
dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet
dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Botues

Koalicioni “Të drejtat seksuale dhe
shëndetësore të komuniteteve të
margjinalizuara” MARGJINAT Shkup, Rrjeti për
mbrojtje nga diskriminimi

Autor(e)ë

Stojan Mishev
Margarita Gligoroska

Redaktore

Dragana Drndarevska

Translator

Julija Micova

Redaktimi grafik dhe dizajni

Emilija Em Misheva

Shkup, 2022



МРЕЖА ЗА
ЗАШТИТА ОД
ДИСКРИМИНАЦИЈА



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

LISTA E SHKURTESAVE

APRMV – Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

ISHSSH – Inspektorati shëndetësor dhe sanitar shtetëror

NJVL – Njësitë e vetëqeverisjes lokale

BE- Bashkimi Evropian

LPPA – Ligji për procedurë të përgjithshme administrative

KPMD – Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

RRMD – Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi

MPPS – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

MCMS – Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

SKBJ – Strategjia kombëtare për barazi dhe jo diskriminimet

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

FFM – Federata e Futbollit të Maqedonisë

QPS – Qendra për punës sociale

REZYME

Krahas të drejtës së garantuar me Kushtetutë të qytetarëve për barazi në liri dhe të drejta, miratimi i Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi kontribuoi në përmirësimin e supozimeve normative për promovimin më të madh të barazisë dhe mosdiskriminimit në shoqëri, përmes forcimit të pavarësisë dhe kornizës institucionale të Komisionit për parandalimin e diskriminimit dhe mbrojtjen nga diskriminimi (KPMD), si mekanizëm i specializuar për mbrojtjen e qytetarëve nga ligjet, politikat dhe praktikat diskriminuese¹. Aq më tepër që kompetencat e parapara ligjore mundësojnë një fushë të gjerë veprimi të Komisionit, si dhe ndërlihdhen e ndërsjellë të përpjekjeve të ndërmarra në të gjitha fushat prioritare për trajtimin efektiv të diskriminimit, përkatësisht parandalimin dhe ngritjen e mirëkuptimit publik, promovimin e zbatimit e kornizës ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut dhe sigurimin e mbrojtjes së qytetarëve të cilët kanë qenë të diskriminuar.

Ky raport i Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi synon të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit në punën e Komisionit, si dhe në plotësimin e parakushteve për zbatimin efektiv të Ligjit. Gjatë përgatitjes janë marrë parasysh të dhënat e disponueshme publike për zbatimin e ligjit dhe punën e Komisionit, këndvështrimi i anëtarëve dhe shërbimit profesional të KPMD-së, si dhe perceptimet e organizatave qytetare që punojnë për promovimin e barazisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të grupeve të cënueshme të qytetarëve.

Konkluzioni i përgjithshëm është se mungesa e vullnetit politik për t'u marrë me diskriminimin në shtet dhe mos marrja e masave thelbësore për përmirësimin e situatës aktuale të grupeve të cënueshme të qytetarëve i minojnë angazhimet legjislativë dhe e tregojnë qëndrimin e vërtetë të vendimmarrësve ndaj respektimit të drejtave të njeriut, përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe situatën me barazinë dhe mosdiskriminim në shoqëri. Fatkeqësisht, vazhdon praktika negative afatgjatë e “ndarjes” apo përçarjes ndërmjet proceseve të miratimit të strategjive, politikave dhe ligjeve dhe proceseve të zbatimit të tyre, si dhe ndikimi i partive politike në formimin e organeve të pavarura për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Aq më tepër që vetë angazhimet legjislativë në fushën e ballafaqimit me diskriminimin që u ndërmorën nga shteti në vitin 2019 dhe 2020 kontribuan në rritjen

¹ Analiza e mandatit ligjor të KPMD dhe parakushtet për transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet, Shoqata ESE, 2019, e disponueshme në linkun vijus <http://esem.org.mk/pdf/Publikacii/2019/Analiza%20na%20zakonskiot%20mandat%20na%20KSZD.pdf>

e pasigurisë ligjore mes qytetarëve. Konkretisht, me miratimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në maj të vitit 2019², është vënë në fuqi Ligji i mëparshëm i vitit 2010, e njëkohësisht u ndërpre puna edhe e Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Pavarësisht obligimit ligjor për krijimin e KPMD-së brenda tre muajve pas miratimit të ligjit, anëtarët e Komisionit u zgjodhën nga Kuvendi në janar 2021. Në praktikë, qytetarët nuk kanë pasur qasje në Komisionin si mekanizëm institucional për mbrojtjen nga diskriminimi për gati 2 vjet, megjithëse ky mekanizëm është krijuar që nga viti 2010. Arsyet e moskrijimit të KPMD-së ishin zvarritja e procedurës për zgjedhjen e deputetëve në Kuvend dhe heqja e KPMD-së nga ana e Gjykatës Kushtetuese në shkurt 2020. Së pari, procesi në Kuvend u zgjat dhe anëtarët e KPMD-së nuk u zgjodhën deri në shfuqizimin e ligjit nga Gjykata Kushtetuese, dhe vetë shfuqizimi e zgjati më tej formimin e KPMD-së për shkak të nevojës për miratimin e një ligji të ri dhe organizimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të KPMD-së. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese mori vendim për shfuqizimin dhe jo anulimin e Ligjit, gjë që kontribuoi më tej në rritjen e pasigurisë juridike, për faktin se në periudhën nga shkurti deri në tetor 2020, kur u miratua LPMD³ i ri, nuk kishte asnjë ligj në fuqi, megjithëse mbrojtja nga diskriminimi ishte e rregulluar në një ligj të veçantë që nga viti 2010. Është veçanërisht shqetësues fakti që nuk është penguar zvarritja e këtij procesi edhe përkundër avokimit të vazhdueshëm për themelimin e menjëhershëm të Komisionit nga RRMD-ja, organizatat qytetare dhe ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, bazuar në mangësitë e konstatuara që kanë zgjatur zgjedhjen e anëtarëve të KPMD-së në vitin 2019, RRMD përgatiti amendament për plotësimin e nenit 18 të LPMD-së, i cili i referohet procedurës së përzgjedhjes të anëtarëve të KPMD-së, pra vendosjen e afateve të sakta ligjore për çdo fazë të procedurës. Qëllimi ishte që në të ardhmen të parandalohet zgjatja e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të KPMD-së, por plotësimet e propozuara në LPMD nuk u pranuan nga partitë politike që përbëjnë shumicën qeverisëse në parlament. Arsyetimi për përcaktimin e afateve në procedurën para Kuvendit u konfirmua edhe më tej pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve të Komisionit, kur procedura e përzgjedhjes u zgjat sërish dhe anëtari i shtatë i KPMD nuk u zgjodh fare, pavarësisht shpalljes publike dhe intervistave me kandidatët e paraqitur. Komisioni sot punon me kapacitete edhe më të kufizuara, pra me pesë nga shtatë anëtarët e planifikuar, sepse në vitin 2022 njëri prej anëtarëve dha dorëheqje nga pozita e tij.

Përveç mangësive të përmendura gjatë themelimit të Komisionit, në të njëjtën kohë nuk janë siguruar burimet e nevojshme financiare, njerëzore dhe hapësinore për zbatimin e kompetencave ligjore të këtij organi. Arsyetja kryesore për këtë situatë është mosrespektimi i pavarësisë financiare të parashikuar me ligj të Komisionit dhe autonomia në planifikimin, shpërndarjen dhe ndarjen e mjeteve buxhetore për punën e tij nga Ministria e Financave dhe Kuvendi i RMV-së. Pavarësisht dispozitës ligjore për prezantimin e buxhetit të propozuar nga KPMD para Kuvendit, Ministria e Financave në fakt vendosi për shumën e mjeteve buxhetore, pa organizuar

² Gazeta zyrtare e RMV, nr.101 nga 22 maj 2019

³ Gazeta zyrtare e RMV, nr. 258 nga 30 tetori 2020


konsultime me KPMD-në lidhur me buxhetin e propozuar. Përkundër buxhetit të planifikuar vjetor për punën e KPMD-së në vlerë prej 45.000.000 denarë, në vitin 2022 janë miratuar vetëm 15.000.000 denarë, gjegjësisht 22.000.000 në buxhetin për vitin 2023. Problem shtesë është se Komisioni nuk mund t'i ndajë në mënyrë të pavarur burimet e miratuara financiare sipas nevojave, gjë që praktikisht krijon mundësinë që mjetet e miratuara të mos shpenzohen edhe pse janë të pamjaftueshme për nevojat e Komisionit. Sa për ilustrim, edhe pse Komisioni në propozim-buxhetin për vitin 2023 kishte planifikuar mjete për realizimin e funksionit promovues dhe parandalues, në buxhet ato nuk ishin miratuar fare, por ishin miratuar mjete për pajisje teknike, të cilat realisht nuk ishin të nevojshme duke pasur parasysh se vitin e kaluar tashmë ishin përdorur mjete për këtë qëllim nga Komisioni. Praktikisht nuk u miratuan mjete financiare as për zbatimin e kompetencave të zgjeruara të Komisionit, as për punësime të reja në shërbimin profesional. Në vitin 2021 nuk janë miratuar punësime të reja në KPMD, në vitin 2022 janë vetëm tre, ndërsa në vitin 2023 nuk parashikohen sërish punësime të reja në KPMD. Komisioni punon me një të pestën e burimeve njerëzore të nevojshme, nëse merret parasysh se kundrejt gjithsej 57 vendeve të planifikuara të punës në shërbimin profesional të Komisionit, janë plotësuar vetëm 11 vende pune, kryesisht nëpërmjet marrjes së nëpunësve administrativ nga institucionet e tjera. Si rezultat i kësaj praktike, kufizohet mundësia e punësimit të personave të pavarur dhe ekspertëve në shërbimin profesional të KPMD-së, gjë që ndikon edhe në kapacitetet për zbatimin e kompetencave ligjore të Komisionit. Zgjidhja e vetme për tejkalimin e situatave të tilla negative është respektimi i pavarësisë financiare të garantuar me ligj të KPMD-së dhe sigurimi i burimeve adekuate financiare dhe njerëzore për zbatimin efektiv të ligjit. Sa i përket dokumenteve strategjike dhe akteve të brendshme të Komisionit, janë miratuar Plani Strategjik për periudhën 2021-2026, Programi vjetor për vitin 2022 dhe Rregullorja e punës. Komisioni ende nuk e ka miratuar strategjinë e komunikimit, edhe pse ajo është përgatitur dhe nuk është miratuar as plani i veprimit për komunikim. Njëkohësisht nuk janë miratuar dokumente të tjera të parapara me Planin Strategjik 2021-2026, të cilat kanë rëndësi të madhe për punën e Komisionit, si plani për forcimin e kapaciteteve, akti i brendshëm për barrën e provës, rregulloret për punësim për organizim të brendshëm të shërbimit profesional, strategjia për parandalimin e diskriminimit, plani për avokim lidhur me format strukturore të diskriminimit dhe aktin për informimin tremujor të publikut për rastet e diskriminimit.

Për sa i përket zbatimit të kompetencave ligjore, konkluzioni i përgjithshëm është se Komisioni e zbaton pjesërisht funksionin promovues-parandalues dhe mbrojtës, ndërsa funksioni këshilldhënës-profesional ende pritet të funksionojë.

Funksioni promovues dhe parandalues i **Komisionit ka për qëllim rritjen e** ndërgjegjësimit të publikut dhe përmirësimin e të kuptuarit publik në lidhje me barazinë, diversitetin dhe mosdiskriminimin. Fjala është për një funksion kompleks që duhet të kontribuojë në tejkalimin e qëndrimeve ekzistuese, stereotipave dhe paragjykimeve ndaj grupeve të ndryshme të cenueshme të qytetarëve, pra në uljen e pabarazisë dhe diskriminimit në shoqëri. Ky funksion i Komisionit përbëhet nga aktivitete për promovimin e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminim; rritjen e ndërgjegjësimit, informimin dhe edukimin e publikut; kontribut në përgatitjen e materialeve nga fusha e arsimit formal dhe joformal; dhënia e rekomandimeve të përgjithshme për çështje specifike; dhe përgatitja e raporteve të veçanta tematike për çështje specifike në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. Konkluzioni i përgjithshëm është se ekziston një nivel i ndryshëm i kryerjes të kompetencave ligjore të deklaruara të Komisionit. Komisioni ka ndërmarrë aktivitete fillestare për njohjen e qytetarëve me punën e tij, si dhe aktivitete parandaluese për ndërgjegjësimin e publikut, informimin dhe edukimin, përgatitjen e rekomandimeve të përgjithshme për grupe të caktuara të cenueshme të qytetarëve, por pothuajse nuk janë realizuar fare aktivitetet në aspektin e sigurimit të kontributit në përgatitjen e programeve në fushën e arsimit formal dhe joformal dhe përgatitjen e raporteve tematike për çështjet që kanë të bëjnë me barazinë dhe mosdiskriminimin.

Funksioni mbrojtës i Komisionit ka për qëllim sigurimin e mbrojtjes së qytetarëve që kanë qenë viktimë të diskriminimit duke vepruar sipas parashtrësave të paraqitura për mbrojtje nga diskriminimi; fillimin e procedurave sipas detyrës zyrtare; informimi i qytetarëve për të drejtat e tyre; monitorimi i ekzekutimit të mendimeve dhe rekomandimeve për raste të veçanta të diskriminimit; forcimin e mbrojtjes gjyqësore kundër diskriminimit nëpërmjet ndërhyrjes ose përfshirjes në procedurat gjyqësore të Komisionit; informimi tremujor i publikut për rastet e diskriminimit; dhe publikimi i vendimeve të miratuara të Komisionit. Në të shumtën e rasteve për këtë funksion përdoren burimet financiare dhe njerëzore të Komisionit, gjë që rezulton me një zbatim më të madh të kompetencave në krahasim me kompetencat në kuadër të dy funksioneve të tjera. Në të njëjtën kohë, Komisioni është më së shumti i përfshirë në trajtimin e parashtrësave për mbrojtje nga diskriminimi, ndërsa pjesa tjetër e kompetencave ligjore në kuadër të funksionit mbrojtës janë zbatuar pjesërisht. Është vërejtur rritje e efikasitetit në trajtimin e ankesave, paralelisht me rritjen e numrit të ankesave të paraqitura për mbrojtje nga diskriminimi. Për ilustrim, në periudhën nga janari 2021 deri në mars 2022, Komisioni ka vepruar në gjithsej 224 kërkesa për mbrojtje nga diskriminimi, nga të cilat pothuajse 80% kanë përfunduar. Në vitin 2021, KPMD ka proceduar 167 ankesa për mbrojtje nga diskriminimi, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2022 kur ka trajtuar 95 ankesa.

Funksioni këshillëdhënës-profesional i Komisionit synon të promovojë zbatimin e kornizës ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin. Në suaza të këtij funksioni përfshihen monitorimi i zbatimit të LPMD-së dhe dhënien e mendimeve dhe rekomandimeve; angazhimi për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe në fushën e të drejtave të njeriut dhe monitorimi i zbatimit të tyre; kontributi në përgatitjen e raporteve shtetërore për organet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre; harmonizimi i legjislacionit, rregulloreve dhe praktikave kombëtare me instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut; inicimi i ndryshimeve në rregullore; dhënien e mendimeve për ligjet e propozuara me rëndësi për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Komisioni në punën e deritanishme i zbaton në masë shumë të vogël kompetencat në kuadër të funksionit këshillëdhënës-profesional, për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, duke përfshirë njohuritë dhe aftësitë e anëtarëve dhe të punësuarve në shërbimin profesional në raport me kornizën ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi dhe zbatimin e kompetencave individuale në kuadër të këtij funksioni.



KONKLUSIONE

Funksioni promovues parandalues

Konkluzioni i përgjithshëm është se KPMD i zbaton pjesërisht kompetencat e veta ligjore në lidhje me funksionin promovues dhe parandalues, kryesisht si rezultat i fondeve të pamiratuara buxhetore dhe burimeve njerëzore të kufizuara për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin. Të gjitha aktivitetet e kryera nga Komisioni financohen nga donatorë të jashtëm, të cilët janë të përfshirë edhe në vetë planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve. Në një situatë të tillë, prioritetet dhe drejtimit nga vetë donatorët patën një ndikim të madh në llojin dhe shtrirjen e aktiviteteve parandaluese të kryera nga Komisioni. Për më tepër, aktivitetet parandaluese të realizuara janë kryesisht përmes bashkëpunimit me organizatat qytetare dhe ndërkombëtare në formë të mbështetjes në fushatat e tyre, e më pak përmes zbatimit të pavarur të aktiviteteve në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, Komisioni ende nuk e ka miratuar Strategjinë për komunikim dhe planin për komunikim, të cilat do të jenë bazë për rritjen e vizibilitetit të këtij organi në publik, si dhe për synimin e grupeve specifike të synuara me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publiku i përgjithshëm dhe ai profesional për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Ndikimi i aktiviteteve parandaluese të zbatuara është i kufizuar, duke qenë se kanali kryesor i komunikimit me publikun janë mediat sociale, për dallim nga përfaqësimi i pamjaftueshëm i mediave tradicionale, të cilat kanë një ndikim më të madh në ndërgjegjësimin e publikut.

Në përgjithësi, ka pasur një përmirësim në drejtim të transparencës dhe publikimit të të dhënave nga KPMD, kryesisht përmes mediave sociale dhe faqes së internetit të KPMD-së. Komisioni ka ndërmarrë aktivitetet fillestare për të promovuar punën e tij në publik dhe procedurën për mbrojtjen nga diskriminimi, përmes përgatitjes dhe lançimit ueb faqes të re, përgatitjes dhe transmetimit të videove individuale me anëtarët e KPMD, si dhe video të animuara se çfarë është diskriminimi dhe udhëzimet se si të raportohet diskriminimi. Në këtë drejtim është bërë një hap pozitiv me krijimin e një ueb faqe të re që përmban informacione sipas nevojave të grupeve të cënueshme të qytetarëve. Ueb faqja përmban informacione për mënyrën e raportimit të diskriminimit, me një mundësi shtesë për raportim elektronik, si dhe është krijuar një formular që mund të plotësohet nga qytetarët që e dërgojnë ankesën me postë ose personalisht te Komisioni. Në ueb faqe janë publikuar edhe LPMD, Plani strategjik, plani vjetor dhe Rregullorja e punës së KPMD-së, si dhe informacione të veçanta për prokurimet publike të kryera nga KPMD. Rëndësi të veçantë ka edhe publikimi i raporteve periodike për punën e Komisionit dhe vendimet e miratuara nga KPMD pas parashtrësave të dorëzuara për mbrojtje nga diskriminimi, duke

përfshirë një seksion analitik që ofron mundësinë e kërkimit të informacionit për rastet, si p.sh. bazën dhe fushën e diskriminimit, si dhe statusin e subjektit.

Ajo që mungon në raport me të dhënat e publikuara është mospublikimi i informacionit apo procesverbalit të seancave të mbajtura që mund të jetë tregues i pavarësisë dhe cilësisë së punës së Komisionit. Ndikimi mbi publikun e gjerë është i kufizuar për faktin se media sociale është ende kanali kryesor i komunikimit. Prandaj, është e nevojshme të intensifikohet komunikimi me publikun përmes mediave tradicionale dhe aktivizimi i KPMD-së në nivel lokal, gjë që do të mundësojë njohjen më të madhe të publikut të gjerë dhe profesional me kompetencat e KPMD-së dhe çështjet që i përfaqëson ky organ. Një hap pozitiv në këtë drejtim është bërë me organizimin e ditëve të hapura për publikun në 7 qytete në vitin 2022, ku qytetarët u informuan se çfarë përbën diskriminim dhe procedurën e mbrojtjes para Komisionit. Janë organizuar trajnime edhe nga ana e KPMD për përfaqësuesit e NJVL, QPS, APRM dhe institucioneve të tjera në 8 qytete të vendit, me fokus të drejtat e romëve dhe procedurën për mbrojtjen nga diskriminimi. Gjithashtu, Komisioni organizoi vizita të drejtpërdrejta në familjet romë në disa komuna të vendit, me synimin për të kontaktuar këtë grup të cenueshëm të qytetarëve.

Komisioni ka përgatitur gjithsej 6 rekomandime të përgjithshme për tejkalimin e problemeve specifike me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara dhe romët. Më konkretisht, KPMD ka publikuar katër rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e situatës së personave me aftësi të kufizuara për sa i përket aksesit në imunizim (pikat e vaksinimit) në kushtet e një pandemie, mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të dënuar me aftësi të kufizuara gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet ndëshkuese, zbatimin e dispozitave të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe sigurimin e qasjes dhe përshtatjes së duhur të qendrave të votimit në të gjithë vendin. Dy rekomandimet e tjera të përgjithshme i referohen përmirësimit të situatës së romëve, në lidhje me sigurimin e ujit të pijshëm nga NJVL dhe heqjen e segregacionit në arsim për nxënësit romë. Rekomandimet e përgjithshme janë përgatitur duke u bazuar në problemet që janë evidentuar përmes parashtresave individuale për mbrojtje nga diskriminimi të paraqitura nga këto grupe të cenueshme të qytetarëve. Kriteret që Komisioni i zbaton kur jep rekomandime të përgjithshme janë numri i rasteve me të njëjtin problem, pesha dhe urgjenca e problemit të identifikuar. Nga ana tjetër, gjetjet nga trajtimi i parashtresave për mbrojtje nga diskriminimi tregojnë se me diskriminim të shpeshtë ballafaqohen edhe grupet e tjera të cenueshme të qytetarëve, siç është diskriminimi i komunitetit LGBTI përmes rrjeteve sociale, për të cilin Komisioni ende nuk ka dhënë një rekomandim të përgjithshëm. Përveç veprimit në parashtresat për mbrojtje nga diskriminimi, Komisioni nuk i përdor kompetencat e tij të tjera për të identifikuar grupet e cenueshme të qytetarëve apo çështjet që kërkojnë dhënie të rekomandimeve të përgjithshme, si monitorimi i zbatimit dhe harmonizimit të legjislacionit, rregulloreve dhe praktikave tona me konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuadër të funksionit këshillëdhënës-profesional. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për identifikimin e grupeve të caktuara të cenueshme të qytetarëve që kanë paraqitur më pak ankesa për mbrojtje

nga diskriminimi, megjithëse diskriminimi ndaj tyre është konfirmuar në një sërë dokumentesh të organeve ndërkombëtare dhe rajonale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç janë gratë.

Funksioni mbrojtës i KPMD

Pjesa më e madhe e kohës dhe burimeve të Komisionit iu kushtuan kryerjes së funksionit mbrojtës, kryesisht në pjesën e trajtimit të ankesave të paraqitura për mbrojtje nga diskriminimi. Në të njëjtën kohë, Komisioni ka marrë masa për lehtësimin e procedurës për raportimin e diskriminimit, duke krijuar mundësinë e dorëzimit elektronik të ankesës përmes ueb faqes së Komisionit, si dhe një formular për raportimin e diskriminimit që mund të shkarkohet dhe plotësohet nga qytetarët të cilët parashtrajnë ankesë me postë ose personalisht pranë Komisionit.


Është krijuar një sistem elektronik i cili duhet të sigurojë një shpërndarje të pavarur dhe të barabartë të lëndëve ndërmjet anëtarëve të Komisionit, megjithatë është konstatuar një devijim nga shpërndarja automatike e lëndëve përmes sistemit elektronik, i cili nuk është i rregulluar në rregulloren për veprim sipas lëndëve apo akt tjetër të brendshëm të Komisionit, por janë rezultat i një marrëveshjeje ose mirëkuptimi të ndërsjellë ndërmjet anëtarëve të KPMD-së. Në bazë të ekspertizës dhe trajtimin e mëparshëm të rasteve individuale për mbrojtje nga diskriminimi, ekziston një praktikë që anëtarët të merren vesh dhe të “këmbejnë” rastet që u janë caktuar për punë. Kjo praktikë hap mundësinë e një shpërndarjeje të pabarabartë të burimeve njerëzore që angazhohen për të punuar në rastet e mbrojtjes nga diskriminimi, si dhe angazhim më të madh në punë të disa prej anëtarëve dhe të puësuarve të shërbimit profesional që kanë njohuri dhe aftësi më të mira, krahasuar ndaj kolegëve të tjerë. Në të njëjtën kohë vihet në pikëpyetje pavarësia në shpërndarjen e subjekteve, e cila duhet të sigurohet nëpërmjet sistemit elektronik të shpërndarjes.

Sa i përket mënyrës së komunikimit dhe vendimmarrjes, disa nga lëndët prezantohen dhe diskutohen gojarisht në seancat e Komisionit, ndërsa një pjesë e rasteve komunikohen përmes grupit të brendshëm të e-mailit ku bëjnë pjesë anëtarët e KPMD-së, të punësuarit e shërbimit profesional që i arkivojnë lëndët dhe të punësuarit që punojnë në dërgimin e postës. Në thelb, çdo temë diskutohet në grup, pas së cilës jepen udhëzime për mënyrën e përgatitjes së opinionit dhe më pas, pasi përgatitet, paraqitet dhe merret vendimi përfundimtar nga anëtarët e Komisionit. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, ku anëtarët shpesh arrijnë një konsensus për llojin e vendimit. Edhe pse ka pasur mendime kontradiktore për llojin e vendimeve të marra, deri më tani nuk është përgatitur një opinion i veçantë, sepse perceptimi i anëtarëve të Komisionit është se përgatitja e një opinionit të veçantë parashikohet si mundësi apo e drejtë, e jo si obligim në rastet kur është miratuar mendim, me të cilin vetë nuk pajtohen. Praktikisht, në këtë mënyrë Komisioni siguron një lloj “uniteti” në punën e tij, në atë që

anëtarët që kanë mendime të kundërta pas votimit, në njëfarë mënyre e pranojnë mendimin e shumicës së anëtarëve, por përgatitja e mendimeve të veçanta mund të kontribuojë për përmirësim cilësor të procesit të vendimmarrjes në KPMD dhe në të ardhmen anëtarët duhet ta konsiderojnë përdorimin e kësaj mundësie ligjore në praktikë.

Për llojin e vendimit të marrë, Komisioni ka dhënë mendim në 37% të lëndëve që kanë konstatuar ekzistimin e diskriminimit (66 nga 176), në 28% të lëndëve nuk është konstatuar diskriminim (49 nga 176) dhe 35% nga lëndët u refuzuan (61 nga 176). Fushat më të zakonshme në të cilat KPMD e përcaktoi ekzistencën e diskriminimit janë puna dhe marrëdhëniet e punës (30%), informacioni publik dhe media (30%) dhe qasja në mallra dhe shërbime (23%), ndërsa qytetarët në numrin më të madh të rasteve janë diskriminuar për më shumë se dy arsye (2.2.), kryesisht për shkak të përkatësisë në një grup të marginalizuar (21), karakteristikave personale dhe statusit shoqëror (21), orientimit seksual (16) dhe identitetit gjinor (16).

Është e rëndësishme të theksohet praktika e ndryshme, pra mungesa e një mënyre të unifikuar të shkrimit dhe shpjegimit të opinionëve të KPMD-së. Disa nga opinionet e Komisionit shpjegohen në detaje krahasuar me të tjerat, d.m.th përmbajnë më shumë elemente, si informacione në lidhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, referencë në dispozitat ligjore të legjislacionit vendas që kanë të bëjnë me rastin konkret të diskriminimit, referencë në raste specifike nga praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe/ose vendimeve të gjykatave vendase. Ky ndryshim është rezultat i kapaciteteve të ndryshme, pra njohurive dhe aftësive që i zotërojnë anëtarët individualë të Komisionit dhe të punësuarit e shërbimit profesional që punojnë në këtë lëndë. Ka një praktikë të ndarë në lidhje me respektimin e afateve ligjore në procedurat e KPMD-së. Anëtarët e Komisionit përballen me vështirësi në respektimin e disa afateve ligjore, siç është afati 5 ditor për paraqitjen e ankesës ndaj personit ndaj të cilit është parashtruar, i cili nga ana e tij duhet të përgjigjet brenda 15 ditëve nga dita e marrjes të parashtrësës. Në praktikë, dorëzimi me postë është një problem, ku shpesh KPMD merr informacion kthyes ku deklorohet se personi është njoftuar, pa specifikuar nëse ai është njoftuar për procedurën e nisur përpara KPMD-së apo është njoftuar se duhet të marrë një dërgesë nga posta, e cila është e rëndësishme duke qenë se afatet kalojnë pasi të jetë njoftuar pala në procedurë. Për këtë shkak, Komisioni lejon më shumë se 15 ditët e parashikuara me ligj për të marrë përgjigje, pas së cilës i dërgon një ose më shumë njoftime urgjente personit kundër të cilit është paraqitur ankesa, gjë që e zgjat në fakt të gjithë procedurën. Detyrimi për të publikuar opinionin në Gazetën Zyrtare në një situatë kur autori i diskriminimit refuzon ta marre gjithashtu një nga faktorët që ndikon në zgjatjen e afateve ligjore për veprim. Njëkohësisht nuk ka asnjë akt apo kriter të brendshëm lidhur me veprimet që KPMD i ndërmerr sipas afateve në procedurë.



Një numër i madh i parashtresave për mbrojtje nga diskriminimi janë refuzuar nga Komisioni, kryesisht për shkak të parregullsive, pra për shkak të një parashtruesi të panjohur, një parashtresë të panënshkruar nga kërkuesi, një diskriminues potencial të panjohur ose të paspecifikuar. Në situata të tilla, Komisioni ka vendosur një praktikë të rregullt për parashtrimin e kërkesës tek kërkuesit për rregullimin e parashtresës brenda 8 ditëve, në të cilën i tregon të dhënat që mungojnë dhe duhet të plotësohen, pra nëse kërkuesi nuk i ofron të dhënat e kërkuara brenda afatit të caktuar, KPMD miraton një konkluzion për refuzimin e parashtresës. Mos kompetenca e Komisionit është arsyeja e dytë e refuzimit të kërkesave, ku ka një praktikë të ndryshme në lidhje me formën dhe përmbajtjen e vendimeve për rrëzimin e kërkesës për shkak të mos kompetencës. Disa nga këto vendime emërtohen si njoftim, vendim, përfundim dhe në dy raste janë emërtuar si zgjidhje. Ky dallim është për faktin se Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nuk ka një dispozitë specifike për refuzimin e parashtresës për shkak të mungesës së juridiksionit, gjë që ka kontribuar që Komisioni ta zbatojë Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, në vend të ligjit amë. Kjo është një praktikë negative që duhet të braktiset nga KPMD-ja, veçanërisht për shkak të pasojave që ka zbatimi i Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative në veprimet e mëtejshme të Komisionit, si përgatitja e një udhëzimi ligjor dhe mundësia e kryerjes të një procedure ankimore kundër vendimeve të KPMD-së edhe pse Komisioni nuk është organ administrativ. Nga ana tjetër, dallim ka edhe për sa i përket përmbajtjes së vendimeve me të cilat hidhet poshtë një kërkesë specifike për shkak të mungesës së juridiksionit. Në disa nga vendimet thuhet se në rastin konkret nuk kërkohet përcaktim i diskriminimit ose nuk është diskriminim por shkelje e ligjit, ndërsa në disa vendime Komisioni shpjegon pse nuk është fjala për diskriminim dhe i sqaron parashtruesit ku të drejtohet për të mbrojtur të drejtat e veta ligjore.

Fillimi i procedurave zyrtare është përmirësuar, në shumicën e rasteve pas një informate apo informacioni të publikuar në media. Për ta bërë këtë, kriteret e aplikuar nga Komisioni janë interesi shoqëror, pesha e diskriminimit dhe numri i personave që përfshihen. Përshtypja është se duhet të ndërmerren përpjekje shtesë për iniciimin e procedurave në lidhje me diskriminimin sistematik, paralelisht me rastet (incidentet) individuale të diskriminimit në të cilat ka punuar Komisioni.

Komisioni nuk ka krijuar një sistem të unifikuar për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve për tejkalimin e diskriminimit. Anëtarë të Komisionit e monitorojnë individualisht zbatimin e rekomandimeve me mbështetje teknike nga të punësuarit e shërbimit profesional. Ekziston një praktikë që të kontaktohen diskriminuesit deri sa afati për zbatimin e rekomandimit është duke u informuar nëse janë ndërmarrë veprime të caktuara. Në një situatë kur ata marrin një njoftim nga një autoritet i caktuar qeveritar se rekomandimi i tyre është zbatuar, anëtarët kryejnë inspektime dhe kontrole shtesë për të siguruar që rekomandimi është zbatuar. Komisioni ka parashtruar rreth 40

kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente për shkak të mos respektimit të rekomandimeve, por në asnjë rast nuk është konstatuar se është kryer kundërvajtje nga diskriminuesit. Kjo situatë vjen si pasojë e dispozitave të papërshtatshme kundërvajtëse në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, sipas të cilave gjykata për kundërvajtje rishqyrton nëse ka pasur diskriminim. Sipas formulimit aktual në ligj, diskriminimi i konstatuar është shkelje dhe jo mosrespektim i rekomandimeve të Komisionit. Komisioni ka ndërmarrë aktivitete fillestare për zbatimin e kompetencave në lidhje me ndërhyrjen apo përfshirjen në procedurat gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi. Komisioni është paraqitur si ndërhyrës në dy procedura gjyqësore, në rastin e parë pas ftesës së një organizate qytetare që e ka udhëhequr çështjen në gjykatën themelore, në rastin e dytë pas ftesës së një personi fizik, për të cilin rast Komisioni paraprakisht ka përcaktuar ekzistimin e diskriminimit. Komisioni është paraqitur si mik i gjykatës edhe në dy raste të tjera, edhe pas ftesës nga organizatat qytetare. Për më tepër, në një lëndë Komisioni në fakt është thirrur si dëshmitar, sepse Ligji për procedurën civile nuk ka dispozita për të vepruar si “mik i gjykatës”. Kjo praktikë e gjykatës është e gabuar duke qenë se Komisioni nuk ka qenë dëshmitar i ngjarjes, por ka konstatuar diskriminim ose më mirë segregacion ndaj fëmijëve romë në fushën e arsimit. Në të njëjtën kohë, është konstatuar nevoja që KPMD të përfshihet më aktivisht në rastet gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, veçanërisht nëse bëhet fjalë për një rast në të cilin tashmë kanë konstatuar ekzistimin e diskriminimit.

Komisioni ka përgatitur vetëm një ekspertizë lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftime, pas kërkesës së një partie politike. Për sa i përket informimit publik tremujor dhe shpalljes së vendimeve të Komisionit, vërehet se ka një praktikë të parregullt të publikimit të raporteve tremujore për punën e Komisionit⁴, ndërsa opinionet e miratuara dhe rekomandimet e KPMD-së publikohen rregullisht në ueb-faqen e Komisionit.

Funksioni këshillëdhënës profesional

Komisioni në punën e deritanishme në masë të vogël i ka zbatuar kompetencat në kuadër të funksionit këshillëdhënës-profesional. “Neglizhimi” i këtij funksioni nga Komisioni vjen si pasojë e mungesës së burimeve njerëzore, përfshirë njohuritë dhe aftësitë e anëtarëve dhe të punësuarve të shërbimit profesional në lidhje me kornizën ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi dhe zbatimin e kompetencat individuale brenda këtij funksioni.

⁴ Deri më tani janë publikuar tre raporte tremujore, i pari për periudhën janar-maj 2021, raporti i dytë tremujor për periudhën qershor-shtator 2021, ndërsa raporti i tretë tremujor është për periudhën janar-mars 2022.

REKOMANDIME

Përmirësimi i parakushteve për zbatimin e kompetencave ligjore të KPMD

- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të përfundojë sa më shpejt procedurën për zgjedhjen e anëtarit të shtatë të KPMD, në bazë të shpalljes publike të bërë dhe intervistave me kandidatët e paraqitur, duke pasur parasysh pavarësinë dhe ekspertizën e tyre për të kryer funksionin e cekur.
- Ministria e Financave duhet të mundësojë zbatimin e nenit. 15 të Ligjit, përkatësisht Komisioni duhet në mënyrë të pavarur të planifikojë dhe të shpërndajë mjetet buxhetore për punën e tij, ndërsa Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut të organizojë prezantimin e propozim-buxhetit nga ana e KPMD dhe miratimin e tij.
- Të kompletohet shërbimi profesional i KPMD-së përmes punësimeve të reja, në bazë të shpalljes publike, me qëllim të kontribuojë për pavarësinë dhe ekspertizën më të madhe të punësuarve.
- Komisioni t'i miratojë aktet dhe dokumentet e brendshme që do të mundësojnë ekzekutim më efektiv të kompetencave ligjore: Plani i aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve, Akt i brendshëm për barrën e provës, Rregullorja për punësimin dhe marrëdhëniet e punës, Plani për avokim lidhur me format strukturore të diskriminimit, Rregullore për organizimin e brendshëm të Shërbimit profesional, Strategjia për parandalimin e diskriminimit dhe Akti për informimin publik tremujor për rastet e diskriminimit.

Funksioni promovues parandalues i KPMD

- Të planifikohen dhe shpërndahen fondet e duhura buxhetore dhe burimet njerëzore për zbatimin e aktiviteteve promovuese dhe parandaluese nga ana e KPMD.
- Forcimi i njohurive dhe aftësive të anëtarëve të Komisionit dhe të punësuarve në shërbimin profesional për zbatimin e kompetencave ligjore në kuadër të funksionit promovues dhe parandalues.
- Të miratohet Strategjia për komunikim dhe Plani vjetor i veprimit për komunikim të KPMD-së, me tregues të përcaktuar, afat kohor, personat përgjegjës dhe buxhetin e kërkuar, që do të përfaqësojë bazën për zbatimin e funksionit promovues dhe parandalues të Komisionit.
- KPMD t'i thellojë kanalet e komunikimit me publikun, përmes prezencës më të madhe në stacionet televizive dhe të radios kombëtare, si dhe përdorimit të kanaleve alternative për komunikim me grupet e cenueshme të qytetarëve, si takime të drejtpërdrejta, vizita në komunitetet e cenueshme etj.
- Komisioni duhet të marrë masa për zbatimin e barabartë të aktiviteteve individuale në kuadër të funksionit promovues dhe parandalues, veçanërisht kontributin në përgatitjen e programeve në fushën e arsimit formal dhe joformal dhe përgatitjen e raporteve tematike për çështjet lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin.

- Komisioni duhet të rrisë bashkëpunimin me Ministrinë e Arsimit dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit dhe të përfshihet në mënyrë proaktive në procesin e rishikimit të teksteve shkollore.
- Komisioni duhet të prioritetizojë çështjet nga puna e mëparshme pas parashtresave të dorëzuara për mbrojtje nga diskriminimi, të cilat do të shtjellohen më në detaje në publik përmes përgatitjes së raporteve tematike.
- Komisioni duhet të përfshihet në mënyrë proaktive në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të aktiviteteve parandaluese të zbatuara në ndërgjegjësimin e publikut.
- Komisioni duhet të thellojë llojin e aktiviteteve parandaluese, duke përfshirë grupe të ndryshme të cënueshme të qytetarëve, dhe në të njëjtën kohë të rrisë numrin e aktiviteteve parandaluese promovuese të ndërmarrja.
- Komisioni duhet të rrisë prezencën e tij në mediat tradicionale, pra televizionet kombëtare, për të njohur publikun me punën e tij dhe për të përmirësuar mirëkuptimin për barazinë dhe mosdiskriminimin në shoqëri.
- Komisioni duhet të vazhdojë me organizimin e ditëve të hapura për publikun e gjerë në qytetet e tjera dhe veçanërisht në zonat rurale të vendit.
- Komisioni duhet të vazhdojë me organizimin e trajnimeve për NJVL-të dhe institucionet kompetente në nivel lokal, duke thelluar tematikat e trajnimeve në lidhje me grupet e tjera të cënueshme të qytetarëve, si gratë, komuniteti LGBTI, punonjësit e seksit, personat që përdorin drogë, etj.
- Është e nevojshme që Komisioni të marrë masa për shfrytëzimin e kompetencave ligjore brenda të gjitha funksioneve, si bazë për identifikimin e çështjeve prioritare për të cilat është e nevojshme të jepen rekomandime të përgjithshme. Më pas, në bazë të prioritetizimit, duhet të rritet numri i rekomandimeve të përgjithshme nga Komisioni.

Funksioni mbrojtës i KPMD

- KPMD të ndërmarrë aktivitete për unifikimin e formës dhe përmbajtjes në opinionet e miratuara pas parashtresave të dorëzuara për mbrojtje nga diskriminimi.
- Anëtarët dhe të punësuarit në shërbimin profesional të ndjekin trajnime për të forcuar kapacitetet e tyre për të shkruar parashtresa/mendime me shkrim, standardet dhe praktikën ndërkombëtare dhe të tjera, si dhe të përgatisin një program për transferimin e brendshëm të njohurive dhe aftësive (mentorim) në suaza të KPMD.
- Komisioni duhet të përgatisë udhëzime të brendshme që do të përfshijnë tregues për cilësinë e opinionëve të përgatitura, si dhe një formular të veçantë që do të përmbajë elementet që duhet të shpjegohen në opinion, sipas bazës dhe fushës së diskriminimit.
- Komisioni duhet të bëjë një analizë më të detajuar të respektimit të afateve ligjore dhe aspekteve praktike të procedurës që kanë ndikim në kohëzgjatjen e procedurës, e cila do të shërbejë si bazë për ndryshimin/plotësimin e Ligjit apo miratimin e kriterëve të brendshme precize për marrjen e veprimeve nga KPMD në përputhje me afatet në procedurë.
- Komisioni duhet të krijojë një sistem të unifikuar për monitorimin e përmbushjes së rekomandimeve, duke përfshirë një sistem elektronik që do të mundësojë që të ndërmerren veprime në kohë kundër autorëve të diskriminimit të cilët nuk i respektojnë rekomandimet e Komisionit.

- Komisioni duhet të iniciojë një ndryshim në nenin 41 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, me qëllim që të mundësohet mbarëvajtja e procedurës për kundërvajtje dhe sanksionimi i diskriminuesve që nuk i respektojnë rekomandimet e Komisionit.
- Nevojitet përfshirja më e madhe e Komisionit në identifikimin e problemeve sistematike për të cilat do të iniciohet një procedurë sipas detyrës zyrtare.
- Unifikimi i mënyrës së procedurës dhe sqarimi i detajuar i vendimeve për refuzimin e parashtrësive për shkak të moskompetencës së Komisionit, duke përfshirë informacionin për dallimin ndërmjet diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut dhe udhëzimin e parashtruesit në institucionet kompetente dhe gjykatën.
- Komisioni duhet të krijojë një praktikë të rregullt të publikimit të raporteve tremujore për punën e tij.
- Komisioni duhet të marrë masa për ta njoftuar publikun me opinionet dhe rekomandimet e miratuara të KPMD përmes përdorimit të mediave tradicionale, d.m.th. të stacioneve televizive dhe radiove kombëtare, si dhe nëpërmjet përdorimit të kanaleve alternative të komunikimit që janë veçanërisht të rëndësishme për qasje në grupet e cenueshme të qytetarëve.
- Promovimi më i madh i ndryshimeve pozitive që kanë ndodhur në drejtim të tejkalimit të diskriminimit si rezultat i rekomandimeve të KPMD-së në raste të veçanta.
- Të intensifikohet ndërhyrja dhe përfshirja në procedurat gjyqësore në të gjitha rastet për të cilat KPMD ka konstatuar më parë ekzistencën e diskriminimit. Gjithashtu, Komisioni duhet të marrë masa për monitorimin e procedurave gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi dhe në bazë të konstatimeve të marrë vendim për ndërhyrje.
- Është e nevojshme që Komisioni të marrë masa për rritjen e numrit të opinionëve të ekspertëve, nëpërmjet monitorimit sistematik të proceseve të miratimit të ligjeve dhe politikave.

Funksioni këshillëdhënës profesional

- Përgatitja e një plani të veçantë me tregues për zbatimin e kompetencave individuale në kuadër të funksionit këshillëdhënës-profesional.
- Organizimi i edukimit të vazhdueshëm, gjegjësisht forcimi i njohurive dhe aftësive të anëtarëve dhe të punësuarve në shërbimin profesional të KPMD-së për kornizën ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin;
- Krijimi i një sistemi për monitorimin e miratimit dhe zbatimit të kornizës ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për të drejtat e njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin.

LITERATURA

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. "Gazeta zyrtare e RMV", nr.50/10
Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. "Gazeta zyrtare e RMV", nr.101/19
Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. "Gazeta zyrtare e RMV", nr.258/20
Strategjia kombëtare për barazi dhe mosdiskriminim (2022-2026). Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

I disponueshëm në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/strategija>

Plani strategjik i Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (2022-2026). Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

I disponueshëm në: <http://kszd.mk/>

Programi vjetor për punën e KPMD për vitin 2022. Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

I disponueshëm në: <http://kszd.mk>

Rregullorja për punë e KPMD. Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

I disponueshëm në: <http://kszd.mk/>

Analiza e mandatit ligjor të Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe parakushtet për transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet. Shkup: Shoqata ESE, 2019.

I disponueshëm në: <http://www.esem.org.mk/>

Hulumtim për përvojat dhe njohuritë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi i grupeve të cënueshme të qytetarëve. Shkup: Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave, 2019.

I disponueshëm në: <http://esem.org.mk/pdf/Publikacii/2020/Zastita%20od%20diskriminacija.pdf>

Raport mbi zbatimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi 2011-2018. Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara" MARGJINAT Shkup, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, 2019.

I disponueshëm në: http://coalition.org.mk/wpcontent/uploads/2019/07/Diskriminacija_web.pdf

Raport vjetor i Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

I disponueshëm në: <https://kszd.mk>

Raporte tremujore të Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, janar-maj 2021; qershor-shtator 2021; janar-mars 2022. Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

I disponueshëm në: <http://kszd.mk/>

Rrjetet sociale të Komisionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (ueb faqja dhe faqja e Facebook).

I disponueshëm në: <https://kszd.mk/> и <https://www.facebook.com/kszd.mk>

Kotevska, Biljana. Udhëzues për Bazat e diskriminimit. Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Shkup: OSBE, 2013.

I disponueshëm: <https://www.osce.org/files/f/documents/b/8/116790.pdf>

North Macedonia Report 2021. Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations, 2021.

I disponueshëm: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2021_en

